

Në bazë të nenit 4, të Ligjit për siguri në trafikun rrugor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 169/15, 226/15, 55/16, 11/18, 83/18, 191/18, 70/19 dhe 98/19)) dhe nenit 27, paragrafit 1, pikës 6, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.09.2019, e miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TRAFIKUN NË KAMPUS

I. Objekti i rregullimit

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet rregullimi i trafikut brenda kampusit të Universitetit.

II. Mënyra e kontrollimit të trafikut në kampus

Neni 2

Shpejtësia maksimale e lejuar brenda kampusit të Universitetit është 20 km/h.

Neni 3

- (1) Pjesa e parkingut është e ndarë në parking për stafin, studentët dhe vizitorët e Universitetit. Studentët mund të parkohen vetëm në hapësirat e dedikuara për parkim të studentëve.
- (2) Në pjesën e mbuluar me panele fotovoltaike mund të parkohen vetëm personat që bëjnë pagesë mujore, sipas akteve normative të Universitetit.

Neni 4

- (1) Hyrja e automjeteve në zonat e caktuara për këmbësorë nuk lejohet, përveç në rastet kur bëjnë dërgesë apo raste emergjente.
- (2) Bartja e furnizimit me automjete për restorantet dhe njësitë tjera tregtare, do të bëhet nga ora 17:00 deri në orën 09:00, por vetëm në pjesën e asfaltuar, ndërsa për pjesën e shtruar me bekatona mund të bëhet vetëm me leje paraprake nga Universiteti.

Neni 5

Shërbimi i sigurimit të Universitetit e realizon zbatimin e kësaj rregulloreje.

III. Sanksionet

Neni 6

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje, do të shënohet nga Shërbimi i sigurimit, i cili mund të japë vërejtje me gojë dhe me shkrim. Shkeljet e përsëritura i raportohen Zyrës së burimeve njerëzore, e cila mund të japë dënim të specifikuar në të holla dhe/ose të iniciojë procedurë disiplinore.

Neni 7

Në rast të përsëritjes së mosrespektimit të kësaj rregulloreje, Shërbimi i sigurimit, do të bllokohet automjetin me bllokator special, ndërsa automjeti do të mund të deblokohet vetëm pas pagimit të gjobës, sipas akteve normative të Universitetit.

IV. Dispozitat përfundimtare

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01.10.2019.